

EUROSAI organizoi Seminarin e Task Forcës për Auditimin e Bashkive, ku KLSH është anëtar, me dt. 5 – 6 nëndor 2018, me temë "Financat e Pushtetit Lokal - Sfidat për të ardhmen"

Organizata Europiane e Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAI) organizoi takimin vjetor të anëtarëve të Task Forcës së EUROSAI-t për Auditimin e Bashkive (TFMA) dhe Seminarin për Auditimin e Bashkive, në Beograd më 5 dhe 6 nëntor 2018, me temën kryesore "Financat e Pushtetit Lokal - Sfidat e ardhshme", ku mori pjesë edhe një grup prej 3 vetash nga KLSH, i përbërë Qemal Shehu, drejtor i departamentit të auditimit të buxhetit vendor, Sali Agaj, auditues i lartë në departamentin e auditimit të performances, Albert Thoma, auditues i lartë në departamentin e auditimit të buxhetit vendor.

Task Forca e EUROSAI për Auditimin e Bashkive u krijua në qershor të vitit 2016, kur Bordi Drejtues i EUROSAI-t mbështeti iniciativën e Zyrës Shtetërore të Auditimit të Lituanisë për të mbledhur Institucionet Supreme të Auditimit, të interesuara për çështjet e auditimit të pushtetit vendor. Kjo Task Forcë, e përbërë nga 26 anëtarë të SAI-ve të Europës, antëtar i së cilës është edhe KLSH, synon të përmirësojë sistemet dhe procedurat në lidhje me auditimin e bashkive, shkëmbimin e praktikave më të mira për të arritur rezultatet e auditimit me ndikim thelbësor në drejtim të përmirësimit të menaxhimit financiar publik, përmirësimit të auditimit të jashtëm që ushtrohet në bashki, në mënyrë që rezultatet të sjellin ndryshime dhe përfitime pozitive si për qytetarët e bashkive ashtu edhe për tatimpaguesit në përgjithësi. Institucioni i kontrollit rajonal financiar i Federatës së Zvicrës, merr pjesë në këtë Task Force me statusin e vëzhguesit.



SAI-t e vendeve anëtare të TFMA

Në seminar morën pjesë rreth 40 përfaqësues të Institucioneve Supreme të Auditimit nga Shqipëria, Austria, Kroacia, Danimarka, Estonia, Bosnje-Hercegovina, Finlanda, Greqia, Hungaria, Izraeli, Italia, Letonia, Lituania, Maqedonia, Malta, Moldavia, Mali i Zi, Polonia, Portugalia, Serbia, Rumania, Sllovakia, Sllovenia, Spanja, Turqia dhe Ukraina.

Gjatë dy ditëve të seminarit, nga pjesëmarrësit u diskutua mbi situatën e financimit të autoriteteve lokale, menaxhimi efektiv financiar dhe përgjegjësitë lokale, huamarrja dhe borxhi si dhe roli i autoriteteve qendrore në këtë proces.



Grup – foto e pjesëmarrësve

Gjatë dy ditëve të zhvillimit të Seminarit u prezantuan metodat e ndryshme për përmirësimin e nivelit të administrimit në pushtetin vendor që është më afër qytetarëve dhe përcaktoi sfidat e fushës së financiare vendore me të cilat përballen shpesh vendet e rajonit.

Pas fjalëve të hapjes dhe përshëndetëse të mbajtura nga presidentët e SAI-ve të Serbisë dhe të Lituanisë u paraqitën temat kryesore të miratuara paraprakisht nga Sekretariati i EUROSAI-t për TFMA, të përqëndruara në problemet e auditimit të pushtetit vendor si: Ndikimi i pushtetit qendror në manaxhimin e financave të qeverisjes vendore; Menaxhimi i një Bashkie në krizë; Përdorimi i punës së audituesve të brendshëm dhe ekspertëve nga SAI në procesin e auditimit të bashkive; etj.

Nga diskutimet u vu theksi te roli i auditimit të jashtëm dhe ndihmesën që duhet të japë Institucioni Suprem i Auditimit në menaxhimin e qëndrueshëm të financave dhe asetëve vendore pronën shtetërore. Rekomandimet e raporteve të auditimit janë kontribut i

çmueshëm jo vetëm për eliminimin e shkeljeve, por dhe në planifikimin dhe ekzekutimin e buxhetit vendor.

Task Forca mbi Auditimin e Bashkive synon të sjellë një qasje të re audituese, për një përdorim të gjerë të gjetjeve audituese, duke mos u kufizuar vetëm tek konstatimi i shkeljeve në bashki. Gjetjet e auditimit mund të hapin horizonte të reja dhe shërbejnë si busull për politikëbërësit, për të gjetur zgjidhje të tjera për përmirësimin e shërbimeve publike: për të siguruar ndryshime sistematike, jo vetëm në pushtetin lokal por edhe në atë qendror, SAI-t duhet të bashkëpunojnë, shkëmbejnë ekspertizë dhe praktikat më të mira për të gjetur rrugë sesi auditimi i bashkive mund të sjellë vlerë të shtuar për të gjithë palët e interesit, me moton **“From Local to Global”**.

Seminari i Task Forcës mbi Auditimin e Bashkive përsëriti faktin se tendencat globale në fushën e menaxhimit të shpenzimeve publike po ndryshojnë nga dimensionimi i disiplinës fiskale tek dimensionimi i performancës, duke u shtrirë në rezultatet e bashkive në drejtim të realizimit të shërbimeve ndaj qytetarëve, duke kërkuar përhapjen e praktikave më të mira në auditimin e bashkive, me qëllim informimin e ligjvënësist, ekzekutivist dhe publikut të gjerë mbi rolin në rritje të auditimit të jashtëm publik në drejtim të përmirësimit të menaxhimit në të gjithë sektorin publik.

Gjatë dy ditëve u organizuan dhe tryeza pune, për përvojat specifike në auditimin e bashkive ku grupi pjesëmarrës nga KLSH-së, u përfshi në diskutimin e çështjeve dhe paraqitjen e situatës së menaxhimit financiar bazuar në auditimet e ushtruara, gjetjet kyçe, rekomandimet dhe vlera e shtuar e KLSH-së si auditim i jashtëm, etj. të pushtetit vendor në Shqipëri, nga KLSH.



Në fund të takimit përfaqësuesit e SAI-ve shqyrtuan aktivitetet që kanë të bëjnë me Planin e Punës në periudhën 2017-2020 dhe veçanërisht në lidhje me planin e

veprimet për vitin 2019, propozimet e parashtruara në këtë takim nuk konsiderohen shteruese, por do të diskutohen online ndërmjet anëtareve të Task Forcës, përpara zhvillimit të aktiviteteve të ardhshme.